

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Messi shënon golin spektakolar nga goditja e dënimit, vetëm dy gola larg rekordit - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/messi-shenon-golin-spektakolar-nga-goditja-e-denimit-vetem-dy-gola-larg-rekordit/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:38:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:26:44 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d8c34b2be86cfe5ae9a30ed2fa00a4d52ac37ef3036806c4f785400d5253a79b
TEKSTI	f20b920300dc43b68783654440d3a310002da03d25235d2e8a90fb600595ca55
PAMJA	6c7c73e9906095ceec470514873ffabf3f4bc1cef2789996eb02bea3e5ce5f1cc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	15e632e3c031c4f7dbb17b8dd86c4e64d385376c1e6c11d798a0d5d2bcf6b088
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/15e632e3c031c4f7dbb17b8dd86c4e64d385376c1e6c11d798a0d5d2bcf6b088>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Rusia Lufta në Iran SHBA Kuvendi i Kosovës Edi Rama

SPORT

Messi shënon golin spektakolar nga goditja e dënimit, vetëm dy gola larg rekordit

28 Shtator 2026 | 18:26

Lionel Messi vazhdon ta bëjë të zakonshmen diçka të jashtëzakonshme.

Argjentinasi shënoi një tjetër gol spektakolar nga goditja e dënimit në ndeshjen e Inter Miamit ndaj Columbus Crew, duke e çuar në 76 numrin e golave nga goditjet e lira direkte në karrierë.

Messi tani është vetëm dy gola larg shifrës së 78 golave, që i atribuohet gjerësisht brazilianit Marcelinho Carioca.

Por mënyra se si erdhi goli është ndoshta edhe më interesante se vetë rekordi.

Në minutën e 33-të, Messi e mori goditjen e dënimit rreth shtatë metra larg vijës fundore, në anën e djathtë të fushës. Pozicioni dukej shumë më i përshtatshëm për një krosim në zonë sesa për një goditje direkte.

Messi mendoi ndryshe.

Me të majtën, ai e ngriti topin mbi mur dhe e dërgoi në këndin e largët, nën traversë, duke e lënë portierin e Columbusit, Patrick Schulte, të shtrirë pa mundësi reale për ta ndaluar. Ishte edhe goli i tij i 21-të në MLS këtë sezon.

Edhe vetë Schulte e pranoi vështirësinë e përballjes me një lojtar të tillë.

“Të ndash fushën me të është padyshim e pabesueshme, por do të preferoja që të mos shënonte kundër meje. Gjithsesi, jam singlerisht i lumtur që në fund morëm tri pikët”, deklaroi portieri i Columbus Creë.

Dhe këtu qëndron një nga statistikatat më të veçanta të evolucionit të Messit.

Që nga viti 2018, Messi ka shënuar më shumë gola nga goditjet e lira direkte sesa nga penalltitë: 36 gola nga goditjet e dënimit, kundrejt 35 nga pika e bardhë, sipas statistikave të publikuara nga beIN SPORTS dhe Mundo Deportivo.

LAJMI I FUNDIT

18:34 Qytetarët në gatishmëri për uraganin Polo në bregdetin e Meksikës në Paqësor

18:21 Greqi, hetimi zbulon burimin e shpërthimit vdekjeprurës në Athinë

18:08 Pas bisedës Vuçiç-Putin, Departamenti i Shtetit rikujton deklaratën e Rubios për çështjet problematike

18:01 Rritet prodhimi i çimentos, betonit dhe llaçit, bien nafta dhe kromi

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

17:57 Vazhdojnë protestat! Spanjë, qytetarët kundër koston së strehimit

17:53 Rusia sulmon Akademinë Kombëtare të Shkencave të Ukrainës, vritet një person

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

SPORT

Persona të panjohur vandalizuan grafitet e Franco Baresi-t në Milano

Persona të panjohur kanë vandalizuar zyrat e AC Milan në Milano, një akt që ka shkaktuar zemërim në Itali. Grafiti i Franco Baresi -t në...

13:59 | 28/09/2026

SPORT

Kombëtarja mbyll përgatitjet në “Shtëpinë e Futbollit” për ndeshjen ndaj San Marinos

Kombëtarja shqiptare ka mbyllur përgatitjet për ndeshjen e dytë në UEFA Nations League ndaj San Marinos, që do të luhet nesër në orën 20:45, në...

13:03 | 28/09/2026

SPORT

Ronaldo u la në stol, Portugalia fiton 2-1 ndaj Norvegjisë

Erling Haaland shënoi golin e tij të 65-të ndërkombëtar për Norvegjinë, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për të rrëmbyer fitoren ndaj Portugalisë. Pasi Joao...

10:50 | 28/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontaktoni

Follow Euronews on all platforms: